L I G J
Nr.7853, datë 29.7.1994

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7746, DATË 28.7.1993 "PËR HIDROKARBURET (KËRKIMI DHE PRODHIMI)"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7746, datë 28.7.1993, në nenin 12, pas pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në lidhje me marrëveshjen e mësipërme, që do të quhet "Marrëveshja Albpetrol":

a) Marrëveshja Albpetrol do të jetë e vlefshme dhe e detyrueshme në përputhje me termat e saj dhe Ministria i jep licencë Albpetrolit siç përmendet atje (në marrëveshje).

Një licencë do ta autorizojë Albpetrolin, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të, për të kërkuar, zhvilluar dhe prodhuar hidrokarbure në zonën e kontratës dhe, në të kundërt, të vazhdojë operaiconet hidrokarbure në zonën e kontratës. Të gjitha dispozitat e këtij ligji, të zbatuara në ose në lidhje me Marrëveshjen Hidrokarbure, do të zbatohen në dhe në lidhje me një licencë, e cila do të ketë fuqi si kontratë.

b) Pa paragjykuar karakterin e përgjithshëm të paragrafit (a) të mësipërm, një licencë mund ta lejojë Albpetrolin, me pëlqimin e Ministrisë, të transferojë dhe të kalojë të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave, titullimit dhe interesit të tij në të një personi juridik, venas a të huaj, ose institucionit ndërkombëtar financiar, me të cilin ai dëshiron të bashkëpunojë për qëllimet e përmendura në Marrëveshjen Albpetrol.

c) Marrëveshja Albpetrol autorizon Albpetrolin të hyjë në Marrëveshje Hidrokarbure, duke autorizuar personin ose institucionin përkatës, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në të, të kërkojë, zhvillojë e prodhojë hidrokarbure në zonën e kontratës dhe, në të kundërt, të vazhdojë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës. Një marrëveshje e tillë Hidrokarbure, e cila nuk do të bjerë në kundërshtim me termat e licencës përkatëse, do të jetë Marrëveshja Hidrokarbure e lidhur sipas këtij ligji".

Neni 2

Në shtojcën bashkëlidhur ligjit, pas pikës 5, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Marrëveshja për autorizimin e kryerjes së operacioneve hidrokarbure, e lidhur më 26 korrik 1993 ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike (sot Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike) dhe Albpetrolit (Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.900, datë 4.8.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha